

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rama: Askush nuk më ndal mua me llogjet e korrupsionit që hedhin pulat histerike - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/rama-pergjigjet-per-situaten-aktuale-askush-nuk-me-ndal-mua-me-llogjet-e-korrupsionit-qe-hedhin-pulat-histerike/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 14:43:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 14:41:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c8ab42ecc86588146063392f42ab695abf1a871ba782a6c4c215e96986734e42
TEKSTI	1050ca368601de397ff09f1fdf44f24000ba1ec556d52e4aa63d6ab66e8f1953
PAMJA	925d6c8e54a100a681abed57f11bfeffa2c7144f093e646fd13987428db6114e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c460d291b1ee85126f19d1124ba10e2be351e4f57d5af0f46c59212d7e205a3b
E MËPARSHMJA	c1b19af7dabd84cc530e20b5d5d0e60370178c42dac702f9162725a9a1a0f4e0
RRËNJA MERKLE	77d68db3023b2e51e8611bf6d5eddb24bf36cfc38da7912ff4d1353a313a25f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c460d291b1ee85126f19d1124ba10e2be351e4f57d5af0f46c59212d7e205a3b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

SHBA Edi Rama Rusia Francë Kuvendi i Kosovës

LAJM KRYESOR | POLITIKË

Rama: Askush nuk më ndal mua me llogjet e korrupsionit që hedhin pulat histerike

25 Shtator 2026 | 16:41

Kryeministri Edi Rama ka reaguar përmes një postimi në platformën X, lidhur me protestat në New York.

Rama iu referuar përdorimit të flamurit kombëtar gjatë protestave, si dhe hedhjes së vezëve e baltës ndaj tij dhe përfaqësuesve të qeverisë.

"Këtyre që mbulohen me flamurin kombëtar dhe çarten rrugëve si pula histerike, u them vetëm se atë flamur e kam ngritur më lart se çka qenë kurrë ndonjëherë në sytë e botës", shkruan Rama.

Kreu i qeverisë shton se kundërshtarët nuk do ta ndalin në atë që e quan misionin e tij për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

"...atyre që kujtojnë se do më ndalin me baltë, vezë dhe jargë, në misionin tim për ta çuar flamurin tonë në majën e Europës së Bashkuar, u them se nëse për herë të parë në historinë e shtetit shqiptar, kemi një sistem institucional që shfaq aftësi vetëpastrimi, kjo është një arritje e madhe që nuk ka rënë nga qielli po ka ardhur pikërisht si një nga rezultatet e këtij misioni!", vijon Rama.

Duke iu referuar debatit për korrupsionin, kryeministri deklaroi se Shqipëria e sotme nuk është më vendi që, sipas tij, ka qenë në të kaluarën.

"Në një vend që është i mbytur në kënetën e korrupsionit, nuk ka luftë frontale e as rezultate konkrete kundër korrupsionit dhe atë vend e kemi jetuar ne, që të gjithë, deri kur unë me partinë time e kthyem rrotën e drejtësisë nga barazia e të gjithëve para ligjit!", shprehet ai.

Rama thotë se sot Shqipëria vlerësohet nga Bashkimi Europian për luftën kundër korrupsionit, ndërsa sulmon kundërshtarët politikë dhe mediatikë që, sipas tij, përdorin këtë çështje për ta goditur qeverinë.

"Sot Shqipëria nuk është më ai vend e prandaj edhe Bashkimi Europian e çmon gjithnjë e më shumë Shqipërinë për këtë luftë", shkruan kryeministri.

Në vijim të reagimit, Rama përdor një gjuhë edhe më të ashpër ndaj protestuesve dhe kundërshtarëve të tij, duke i cilësuar si "pula histerike" dhe duke ironizuar akuzat e vazhdueshme për korrupsion.

LAJMI I FUNDIT

17:59 Sandër Simoni zgjidhet kryetar i Gjykatës së Lartë

17:58 Kredia rëndon familjet, 1 në 4 huamarrës kalon 30% të të ardhurave

17:52 Papa Leo XIV në Francë, pritjet nga 600 mijë besimtarë

17:42 Rritet presioni mbi Infantinin, katër ligat e mëdha evropiane kërkojnë reformë në FIFA

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

17:34 Gjykata e apelit në SHBA refuzon të bllokojë futjen e Anthropic në 'listën e zezë' të Pentagonit

17:31 "Na sulmojnë përmes medias sociale", Rama: Nuk jam avokat për t'i mbyllur ato

TESTIM

“Pulat hysterike të katundit tonë kakarisin e hedhin vezë në ajër për llogari të gjelave tallagjarë të pazarit politik e mediatik, të cilët i gënjen mendja sa një vezë, se do të më ndalin mua me llogjet e pafundme për korrupsionin që po luftohet nga vetë sistemi që po ndërtojmë”, vijon Rama.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

LAJM KRYESOR | POLITIKË | VENDI

Rama deklaratë të fortë nga New York: Joe Biden tradhëtoi Hashim Thaçin “Xhorxh Washingtonin e Prishtinës”

Kryeministri Edi Rama ka deklaruar nga Nju Jorku se Shtetet e Bashkuara mund të kishin bërë më shumë për të mos lejuar, sipas tij, nisjen...

16:28 | 25/09/2026

KOSOVË | LAJM KRYESOR | RAJONI

Kurti: Zgjedhje të reja nëse Kuvendi nuk arrin të zgjedhë presidentin deri më 6 tetor

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti këtë të premte ka deklaruar se do të mbahen zgjedhje të reja në vend në rast se Kuvendi i Kosovës...

15:18 | 25/09/2026

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | VENDI

Ambasadori i ri i SHBA mbërrin në Tiranë, nesër ceremonia e dorëzimit të letrave kredenciale

Ambasadori i ri i SHBA, Eric Wendt ka mbërritur këtë të premte në Tiranë ku nesër mësohet se do të zhvillohet ceremonia e dorëzimit të...

15:05 | 25/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Follow Euronews on all platforms: